

SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2020**Informacione të përgjithëshme****të gjitha balancat janë në lekë përveç rasteve kur cilësohet ndryshe)**

Dhënia e shënimeve shpjeguese në këtë pjesë është e detyrueshme sipas SKK 2 (i përmirësuar). Plotësimi i të dhënave të kësaj pjesë duhet të bëhet sipas kërkesave dhe strukturës standarte të përcaktuara në SKK 2 e përmirësuar. Radha e dhënies së shpjegimeve duhet të jetë:

1. Informacion i përgjithshëm dhe politikat kontabël.
2. Shënimet që shpjegojnë zërat e ndryshme të pasqyrave financiare.
3. Shënime të tjera shpjeguese.

1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM DHE POLITIKAT KONTABËL**1.1 Informacion i përgjithshëm për shoqërinë**

Shoqëria “Ujësjiellës Kanalizime sha Ura Vajgurore” është krijuar si shoqëri anonime me vendim të gjykatës së rrethit Gjyqësor Tiranë nr.29588 datë 22.04.2003. Kapitali i regjistruar i shoqërisë aktualisht është 170.366.002 lekë, numri i aksioneve 1, vlera nominale 170.366.002 lekë.

Kjo shoqëri nuk është e organizuar me filiale. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të ligjit 9901 dt 14.04.2008 “Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare” i ndryshuar si dhe statusi dhe legjislacioni shqiptar në fuqi.

Veprimtaria kryesore tregtare e shoqërisë “UJËSJELLËS KANALIZIME SHA URA VAJGURORE” ”është furnizimi me uje të pijshëm për konsumatorët dhe shitja e ujit në Bashkinë Ura Vajgurore, përfshirë banorët e qytetit dhe fshatrave në përberje të saj; Pashalli, Skrevan, Vokopole, Komunën Poshnjë dhe një pjesë të Komunës Otlak. Mirëmbajtjen e sistemeve të furnizimit me ujë të pijshëm. Prodhimi dhe/ose blerja e ujit për plotësimin e kërkesave të konsumatorëve. Shërbimi i grumbullimit, largimit dhe 2 trajtimit të ujrave të ndotura dhe shitja e tij. Mirëmbajtja e sistemit të ujrave të ndotura si dhe impianteve të pastrimit të tyre.

Selia e Shoqërisë është në Urë Vajgurore.

Shoqëria është e regjistruar në Qendrën Kombëtare të regjistrimit dhe organet tatimore me nr.NUIS K32803022R

Organ drejtues i shoqërisë është Këshilli administrativ

Emri	Funksioni
Petro Kristuli	Kryetar
Petre Sula	Antar
Valentina Jance	Antar

“UJËSJELLËS KANALIZIME SHA URA VAJGURORE” ” shpk administrohet nga Petref Sula. Numri i të punësuar më 31.12.2019 është 50 dhe më 31.12.2020 është 50 punonjës .

Politikat kontabël të vëna në zbatim gjatë ushtrimit kontabël 2020

Kuadri ligjor: Ligji nr.25/2018 date 10.05.2018 (Hyrë në fuqi në datë 01.01.2019) “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” dhe Legjislacioni tatimor në fuqi, si Ligji Nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar si dhe gjithë paketa ligjore fiskale në fuqi përgjatë periudhës 2020.

Kuadri kontabël i aplikuar: Standardet Kombëtare të Kontabilitetit në Shqipëri të përmirësuara, SKK hyrë në fuqi nëpërmjet urdhrit Nr.64 datë 22.07.2014 “Për shpalljen e standarteve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”. Ministria e Financave vendosi të bëjë të detyrueshëm zbatimin e Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara duke filluar nga 1 Janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me publikimin në fletoren Zyrtare Nr.119, datë 01.08.2014

Hartimi i Pasqyrave Financiare 2020 është bërë në përputhje me kërkesat e SKK1 “Kuadër i përgjithshëm për përgatitjen e Pasqyrave Financiare” dhe SKK2 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare” Baza e përgatitjes së Pasqyrave Financiare: Të drejtat dhe detyrimet e konstatuara (SKK 1;1-3)

- Parimet bazë për përgatitjen e pasqyrave financiare (SKK 1;40-90): Parimi i njësisë ekonomike; Parimi i vijimësisë; Parimi i njohjes së shpenzimeve në të njëjtën periudhë ushtrimore në të cilën njihen dhe vlerësohen në mënyrë të besueshme të ardhurat përkatëse; Parimi i kostos historike të amortizuar; Parimi i kompensimit.
- Disa nga karakteristikat cilësore të Pasqyrave Financiare 2020 janë: Kuptueshmëria për përdituesit e informacionit; Rëndësia dhe Materialiteti; Besueshmëria; Përparesia e përmbajtjes ekonomike mbi formën ligjore; Paanshmëria; Plotësia; Maruri; Qëndrueshmëria e politikave kontabël dhe Krakasueshmëria ndër vite.
- Paraqitja e informacionit financiar raportohet në monedhën vëndase, LEKË, si kërkesë ligjore e Ligjit për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare në Republikën e Shqipërisë.
 - Parimin e krahasueshmërisë duke siguruar krahasimin midis dy periudhave.

Bazat e matjes.

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

Biznesi në vijimësi.

Pasqyrat financiare të shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

Monedha funksionale dhe e paraqitjes.

Të dhënat aktuale dhe krahasuese janë prezantuar në Lekë Shqiptare, që është monedha raportuese e shoqërisë.

Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe

supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

- Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

- Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50%, në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

Paketa e plotë e Pasqyrave Financiare dhe hënimeve shpjeguese për vitin 2020 ka si objektiv të pasqyrojë një pamje të vërtetë e të drejtë të informacionit financiar duke u përbërë nga:

- I. Pasqyra e pozicionit financiar (Bilanci kontabël) në të cilën pasqyrohen Aktivet e shoqërisë si dhe financimit të tyre nëpërmjet fondeve të veta (kapital) apo atyre të huazuara (Detyrimet).
- II. Pasqyra e performances (Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve) në të cilën pasqyrohet performanca ekonomike e shoqërisë nëpërmjet rezultatit neto të realizuar, bazuar në të ardhurat dhe shpenzimet e kryera gjatë vitit ushtrimor 2020.
- III. Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare, e cila pasqyron flukset neto të parasë nga aktivitetet e shfrytëzimit, investimit dhe financimit.
- IV. Pasqyra e ndryshimeve në kapitalin neto, tregon ndryshimet në kapitalin e shoqërisë ““UJËSJELLËS KANALIZIME SHA URA VAJGURORE” ” sh.p.k, për periudhën 01 Janar 2020 – 31 Dhjetor 2020.

Një përmbledhje e pjesës më të madhe të politikave kontabël të aplikuara në Pasqyrat financiare janë si më poshtë.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë, paratë në arkë, llogaritë rrjedhëse, depozitat me afat dhe garancitë e vendosura në bankat tregtare vëndase. Për qëllimin e pasqyrës së rrjedhës së parasë, mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë depozita të pakushtëzuara me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit. Overdraftet bankare përfshihen nën zërin hua financiare, tek detyrimet afatshkurtra të bilancit.

Njohja, matja fillestare dhe vlerësimi i mëpasshëm i këtij instrumenti financiar është bërë në përputhje me paragrafët nr 11-21 të SKK-së së përmirësuar nr.3 “Instrumentat Financiarë,, Teprica debitore e mjeteve monetare në monedhë të huaj janë vlerësuar në monedhën bazë me kursin e Bankës së Shqipërisë me datë raportimi 31.12.2020. Cdo transaksion në monedhë të huaj i kryer gjatë periudhës ushtrimore është kryer në përputhje me SKK i përmirësuar nr.12 “Efektii ndryshimeve të kurseve të këmbimit,, paragrafët 13018.

Të drejta të arkëtueshme

Njohja e aktiveve financiare, matja fillestare dhe vlerësimi i mëpasshëm i tyre realizohet duke mbajtur në konsideratë kërkesat e SKK e përmirësuar nr.3 “Instrumentat financiare,, paragrafet nr 11-21. Për vlerësimin e tyre është përdorur metoda e kostos së amortizuar. Përkthimi i instrumentave financiare të arkëtueshëm në monedhë të huaj me kursin e datës së raportimit, shpalluar më 31.12.2020 nga Banka e Shqipërisë mban në konsideratë kërkesat e SKK i përmirësuar nr.12 Efekti i ndryshimeve të kurseve të këmbimit,, paragrafet 13-18.

Llogaritë arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Inventarët

Për tepricën debitoare të zërit inventare, paraqitur në PF, në datën e raportimit 31.12.2020 janë zbatuar parimet e njohjes, matjes dhe vlerësimit të mëpasshëm në përputhje me KK së përmirësuar nr 4 “Inventarët”, paragrafi 8-33.

Kosto e inventarëve të përdorur gjatë periudhës dhe gjëndjes në datën e raportimit të Pasqyrave financiare, është matur-vlerësuar duke përdorur metodën e kostos së mesatares të ponderur.

Inventarët rregjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar. Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme.

Shpenzimet e shtyra dhe të arkëtueshme nga të ardhurat e konstatuara

Shoqëria zbaton politikat e shtyrjes të shpenzimeve të cilat do të sigurojnë të ardhura në periudhat e mëvonshme. Po ashtu ajo shpërndan shpenzimet e parapaguara në vartësi të përdorimit dhe sigurimit të të ardhurave.

Aktive Afatgjata Material

Për trajtimin kontabël gjatë dhe në fund të periudhës raportuese, që nga moment i njohjes për herë të parë të tyre në librat kontabël, duke vijuar më tej me matjen e vlerësimit të tyre në dalje dhe në datën e raportimit financiar me metodën e Kostos së Amortizuar, në përputhje me SKK nr.5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivët Afatgjata Jomateriale” e përmirësuar, paragrafët 8-54, Pasqyrimi i tyre në PF është bërë me Vlerën Kontabël Neto në datën e raportimit. Në metodën e llogaritjes së amortizimit janë mbajtur parasysh dhe kërkesat e Ligjit nr 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar. Neni 22, sipas metodës së përqindjes mbi vlerën e mbetur të aktivit.

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe

transferohen në kategorinë përkatëse të aktivitetit kur përfundon ndërtimi tij, nga ku aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. *Kostot e mëpasshme*

Kostoja e zëvendësimit të një pjesë të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. *Amortizimi*

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivitetit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivitetet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivitetit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2020 dhe 2019 është si më poshtë:

Kategoria	Metoda e amortizimit	Norma e amortizimit
Ndërtesa	Mbi vlerën kontabël neto	5%
Makineri dhe pajisje	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Mjete Transporti	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Mobilje dhe orendi	Mbi vlerën kontabël neto	20%
Pajisje zyresh dhe informatike	Mbi vlerën kontabël neto	25%

iv. *Çregjistrimi*

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitetet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitetet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitetet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Aktivët afatgjatë jomateriale

Një aktiv afatgjatë jomaterial (AAJM) njihet vetëm nëse: është e mundur që të ketë përfitime të ardhshme ekonomike, kostoja e aktivit mund të matet me besueshmëri dhe aktiviteti nuk është rezultat i shpenzimeve të bëra brenda shoqërisë për një zë jomaterial. Njohja fillestare e një aktiv jomaterial bëhet me kosto, ndësa vlerësimi i mëpasshëm paraqitet me koston e tij minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

Detyrimet afatshkurtra

Njohja e detyrimeve afatshkurtra financiare, matja fillestare dhe vlerësimi i mëpasshëm i tyre realizohet duke mbajtur në konsideratë kërkesat e SKK e përmirësuar nr.3 “Instrumentat financiarë”, paragrafi nr.11-21. Për vlerësimin e tyre është përdorur metoda e koston së amortizuar. Përkthimi I instrumentave financiarë të pagueshme në monedhë të huaj me kursin e datës së raportimit, shpallur me 31.12.2020 nga Banka e Shqipërisë mban në konsideratë kërkesat e SKK I përmirësuar nr.12 “Efekti I ndryshimeve të kurseve të këmbimit” paragrafi 13-18.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

Kapitali

Vlera e kapitaleve dhe përbërësve të tij është vlerësuar me vlerën e tyre historike kontabël në përputhje me SKK nr.1 “Kudri i Përgjithshëm për përgatitjen e Pasqyrave Financiare” e përmirësuar, SKK nr.2 “Paraqitja e pasqyrave fiannciare” dhe SKK nr.8 “Të ardhurat” për njohjen dhe evidentimin e rezultatit neto të periudhës ushtrimore.

Të ardhurat dhe shpenzimet

Vlerësimi i të ardhurave dhe shpenzimeve është bërë mbi bazën e parimit të konstatimit të të drejtave dhe detyrimeve në momentin e ndodhjes. Vlerësimi i tyre është bërë sipas përcaktimeve në paragrafet 35-37 të SKK nr.1 “Kudri i përgjithshëm për përgatitjen e Pasqyrave financiare” e përmirësuar si edhe te SKK nr.8 “Të ardhurat” për njohjen dhe matjen e të ardhurave të realizuara gjatë periudhës ushtrimore.

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas parimit të të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Të ardhurat nga shitja e mallrave, materialeve dhe shërbimeve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri të mjaftueshme në marrjen e përfitimeve, paragrafet 16-19 i SKK 8 i përmirësuar. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përlllogariten me besueshmëri, referuar paragrafet 20-43 të SKK 8 i përmirësuar. Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e kthimeve dhe uljeve të ofruara. Shpenzimet njihen atëhere kur ato sigurohen prej të tretëve dhe në të njëjtin ushtrim kontabël me të ardhurat e lidhura, referuar paragrafet nr. 37-39 të SKK 1 “Kudri i përgjithshëm për përgatitjen e Pasqyrave Financiare”.

Transaksionet në monedhë të huaj.

Referuar SKK 12 “Efekti i ndryshimeve të kurseve të këmbimit”, paragrafi nr.11 “Një transaksion në monedhë të huaj në njohje, regjistrohet në monedhën funksionale, duke zbatuar mbi shumën e monedhës së huaj kursin e mënjehershëm të këmbimit (spot) ndërmjet monedhës funksionale dhe monedhës së huaj në datën e transaksionit. Vijohet më tej me raportimin në fund të periudhës raportuese të mëpasshme, paragrafi nr.13 duke:

- përkthyer zërat monetarë të shprehur në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit të mbylljes (në datën e raportimit),
- përkthyer zërat jomonetare që maten me kosto historike në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit,
- përkthyer zërat jomonetarë që maten me vlerën e drejtë në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë.

Njohja e diferencave nga kurset e këmbimit, referuar paragrafet 15-16, që krijohen gjatë shlyerjes së zërave monetarë ose gjatë përkthimit të zërave monetarë me kurse këmbimi të ndryshme nga kurset e këmbimit, me të cilat ato janë përkthyer në njohjen gjatë periudhës kontabël aktuale ose në PF të mëpasshme, njohje si fitim (humbje) të periudhës kontabël kur ato lindin. Kur një zë monetar rrjedh nga një transaksion në monedhë të huaj dhe ka një ndryshim në kursin e këmbimit mes datës së kryerjes së transaksionit dhe datës së shlyerjes së tij, atëhere krijohet një diferencë këmbimi. Kur transaksioni shlyhet në të njëjtën periudhë kontabël në të cilën është kryer e gjithë diferenca e këmbimit njihet në të njëjtën periudhë kontabël. Megjithatë, kur një transaksion shlyhet në një periudhë kontabël të mëpasshme, diferenca e këmbimit, e njohur në secilën periudhë deri në datën e shlyerjes, përcaktohet nga ndryshimi i kurseve të këmbimit gjatë secilës periudhë kontabël.

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale (leke) dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Mjetet monetare në monedhë të huaj konvertohen në lekë me kursin e këmbimit të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë në datën e bilancit. Pra, në çdo datë bilanci, zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kurs zyrtar të këmbimit në datën e bilancit. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve të kompanisë si diferenca të realizuara nga kursi i këmbimit.

Zëra të tjerë jomonetarë në monedhë të huaj konvertohen në lekë duke përdorur kursin e këmbimit të përcaktuar nga Banka e Shqipërisë në datën e Bilancit Kontabël. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve të kompanisë si diferenca të realizuara nga kursi i këmbimit.

Kurset zyrtare të këmbimit më 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 për monedhat kryesore të përdorura në konvertimin e zërave të bilancit në monedhë të huaj janë detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2020	2019
Eur/LEK	123.70	121.77
USD/ LEK	100.84	108.64

Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2020 është 15% (2019: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë. Shqëria nuk ka njohur tatim të shtyrë për humbjet e mbartura fiskale.

Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

Aktivitet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

Vlerësimet kritike të kontabilitetit

Ndërsa situata pandemike COVID-19 akoma po evoluon në mbarë botën, ka pasiguri të lartë mbi shtrirjen e saj në kohën e lëshimit të këtyre pasqyrave financiare. Si pasojë, menaxhimi nuk është në gjendje të vlerësojë me siguri dhe të sigurojë një vlerësim sasior të ndikimit të mundshëm të kësaj pandemie në kompani. Ndërsa masat kufizuese vazhdojnë, volumni i shitjeve, fluksi i parasë dhe fitimi mund të ndikohen. Sidoqoftë, në datën e këtyre pasqyrave financiare, kompania po operon, vazhdon të përmbushë detyrimet e saj në kohën e duhur dhe për këtë arsye vazhdon të zbatojë parimin e vijimësisë në përgatitjen e pasqyrave financiare.

Sistemi kontabël

Sistemi kontabël është i organizuar në përputhje me Ligjin për Kontabilitetin Shqiptar. Shoqëria ka përcaktuar planin e saj të llogarive, në përputhje me Standartin Kombëtar të Kontabilitetit. Shoqëria mban kontabilitetin në regjistrime të kompjuterizuara, duke përdorur tabela në exel.

2. Shënime që shpjegojnë zërat e ndryshëm të pasqyrave financiare

2.1 Mjete monetare

Gjendja e mjeteve monetare në bankë dhe arkë, në lekë dhe në valutë, në datat 31 dhjetor 2020 paraqiten si vijon:

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Monedha	Viti raportues 31.12.2020		Viti raportues 31.12.2019	
			Leke	Valute	Leke	Valute
1	Mjete monetare në arkë	Lekë	-	-	-	-
2	Mjete monetare në bankë	Lekë/Euro/	282.627	-	594.705	-
	Shuma		282.627	-	594.705	-

Gjendjet e llogarive të mjeteve monetare të paraqitura në pasqyrat financiare janë të njëjta me të dhënat e kontabilitetit rrjedhës dhe konfirmohen me tepricat e llogarive bankare dhe inventarët fizikë të mjeteve monetare në arkën e shoqërisë. Tepricat e shprehura në monedhë të huaj janë përkthyer në monedhën vëndase lekë duke përdorur kursin e këmbimit të datës së Pasqyrave Financiare (31 dhjetor 2020) publikuar sipas Bankës së Shqipërisë. Njohja, matja fillestare dhe vlerësimi i mëpasshëm i këtij instrumenti financiar është bërë në përputhje me paragrafët nr 11-21 të SKK-së së përmirësuar nr.3 “Instrumentat financiarë”. Shoqëria kryen transaksionet bankare në Raiffeisen Bank.

2.2 Të drejta të arkëtueshme

Të drejtat e arkëtueshme dhe kërkesa të tjera financiare, në fillim dhe në fund të periudhës ushtrimore kontabël 2020 deklarohen si vijon:

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Viti raportues 31.12.2020	Viti raportues 31.12.2019
1	Nga Aktiviteti i Shfrytëzimit(Kliente)	15.493.762	15.414.485
2	Njesitë Ekonomike Brenda Grupit	-	-
3	Interesa Pjesëmarrëse në Njesi Ekonomike	-	-
4	Të Tjera (Debitore të tjerë)	741.946	1.105.035
	Shteti-Tatim fitimi aktual	-	-
	Shteti-Tatim mbi vlerën e shtuar	254.810	394.921
	Debitore personeli	107.007	317.428
	Te tjera ,nga kontrolli KLSH	380.129	392.686
	Debitore te tjere Bashkia	119.477	-
Shuma		16.355.185	16.519.520

Në zërin “Të drejta të arkëtueshme” janë pasqyruar të drejtat (llogari të arkëtueshme) që shoqëria ka ndaj të tretëve si pasojë e aktivitetit të shfrytëzimit dhe të tjera, ku përmëdim Klientët për detyrimet e pashlyera ndaj furnizimeve të faturuara gjatë vitit ushtrimore 2020 dhe te mbartura. Jante te analizuar ne tabelen e mesiperme.

Llogaria sintetike e Klientëve më 31 dhjetor 2020 rakordon me ato analitike të datës 31.12.2020.

2.3 Inventari

Inventaret, në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabël deklarohen, si vijon:

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Viti raportues 31.12.2019	Viti raportues 31.12.2019
1	Lënde e Parë dhe Materiale të Konsumueshme	1.213.102	1.557.100
2	Inventar I imet	212.485	208.392
3	Prodhime në Proces dhe Gjysëmprodukte	-	-
4	Produkte të Gatshme	-	-
5	Mallra	-	-
6	Aktive Biologjike	-	-
7	AAM të Mbajtura për Shitje	-	-
8	Parapagime për Inventar	-	-
Shuma		1.425.587	1.765.492

Vlerat e inventarit te paraqitura me siper perputhen me te dhenat e kontabilitetit dhe te inventarizimeve fizike te kryer ne fund te ushtrimit 2020. Veprimet ekonomike qe lidhen me hyrjet e daljet jane tranzituar ne llogarite e rezultatit me menyren e inventarit te perhershëm.

Vlerat e paraqitura për inventaret janë vlera me ulët midis kosos dhe çmimit të vlerësuar të shitjes pakësuar me kostot për t'u përfunduar dhe shitur dhe nuk është nevoja për zhvleresime të inventarëve.

2.4 Shpenzime të Shtyra - Nuk ka

2.5 Aktivët Afatgjatë Materiale (AAM-te)

Gjëndja e Aktiveve Afatgjatë Materiale në Pasqyrat Financiare për vitin 2020 paraqiten si vijon:

Nr	Gjendjet dhe levizjet	Toka/Terrene	Ndertesa	Impiante dhe makineri	Mjete transporti	Paisje zyre dhe informatike	Parapagime për Aktive Materiale dhe në Proces	Totali
A	Kosto e AAM-ve 01.01.2019	4.415.840	71.495.955	149.324.268	722.568	636.134		226.594.765
	Shtesat		113.090.924	6.420.000				119.510.924
	Pakësimet	-	-				0	0
	Kosto e AAM-ve 31.12.2020	4.415.840	184.586.879	155.744.268	722.568	636.134	0	346.105.689
							0	0
B	Amortizimi AAM-ve 01.01.2019	0	35.169.901	23.016.739	580.970	445.923	0	59.213.533
	Amortizimi ushtrimit		1.816.303	6.315.376	28.320	47.553		8.207.552
	Amortizimi i shtesave të ushtrimit							0
	Amortizimi për daljet e AAM-ve	-					-	0
	Amortizimi AAM-ve 31.12.2020	0	36.986.204	29.332.115	609.290	493.476	0	67.421.085
							-	0
C	Zhvlerësimi AAM-ve 01.01.2019	-	-	-	-	-	-	0
	Shtesat	-	-				-	0
	Pakesimet	-	-				-	0
	Zhvlerësimi AAM-ve 31.12.2020	-	-	-	-	-	-	0
								0
D	Vlera neto e AAM-ve 01.01.2020	4.415.840	36.326.054	126.307.529	141.598	190.211	0	167.381.232
							-	0
E	Vlera neto e AAM-ve 31.12.2020	4.415.840	147.600.675	126.412.153	113.278	142.658	0	278.684.604

Vlerat dhe klasifikimi në grupe i AAM-ve të pasqyruara në bilanc dhe në tabelën e mësipërme janë të përputhura me të dhënat e kontabilitetit dhe të inventarizimit fizike që shoqëria e ka kryer në fund të muajit dhjetor 2020. Për trajtimin kontabël gjatë dhe në fund të periudhës raportuese, që nga momenti i njohjes për herë të parë të tyre në librat kontabël, duke vijuar më tej me matjen e vlerësimit të tyre në dalje dhe në datën e raportimit financiar me metodën e Kostos së Amortizuar, në përputhje me SKK nr.5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivët Afatgjata Jomateriale” e përmirëzuar, paragrafët 8-54. Pasqyrimi i tyre në PF është bërë me Vlerën Kontabël Neto në datën e raportimit. Në metodën e llogaritjes së amortizimit janë mbajtur parasysh dhe kërkesat e Ligjit nr.8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat, i ndryshuar, neni 22, sipas metodës së paraqitjes mbi vlerën e mbetur të aktivitetit.

Vlerësimi fillestar në momentin e marrjes së aseteve është bërë me koston e blerjes dhe në datën e e mbylljes së bilancit paraqiten me koston e tyre minus amortizimin e akumuluar si dhe pasqyrohen aktivet e blera gjatë vitit me fatura tatimore shitje dhe daljet e tyre për aktivet e blera dalje është llogaritur mortizimi deri në datën e fundit që këto aktive kanë qënë në përdorim të shoqërisë dhe aktivitetit ekonomik.

Drejtimi mendon se përgjithësisht për këtë ushtrim kontabël, nuk ka shënja të rënies në vlerë të AAM-ve dhe nuk ka llogaritur zhvlerësime.

Metoda dhe normat e amortizimit të AAM-ve të përdorura janë të njëjta me ato që përdoren për qëllime fiskale. Masa e llogaritur e amortizimit si shpenzim nuk i tejkalon kufijtë e njohur për efekte fiskale.

Llogaritja e amortizimit është bërë për shumën 8.207.552 lekë, kontabilizuar edhe në shpenzime.

2.6 Detyrimet afatshkurtra

Në këtë post paraqitet gjendja e detyrimeve afatshkurtra më datë 31.12.2020 dhe më 31.12.2019. në shumën respektive 24.285.139 lekë dhe 68.415.154 lekë.

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Viti raportues 31.12.2019	Viti raportues 31.12.2019
1	Titujt e Huamarrjes	-	-
2	Detyrime ndaj Institucioneve të Kredisë	-	-
3	Arkëtime në Avancë për Porosi	-	-
4	Të Pagueshme për Aktivitetin e Shfrytëzimit(furnitore)	18.359.736	59.106.750
5	Dëftesa të Pagueshme	-	-
6	Të Pagueshme ndaj Njës.Ekon. Grup	-	-
7	Të Pagueshme ndaj Njës.Ekon. Pjesëmarrje	-	-
8	Të Pagueshme ndaj Punonjësve dhe Sigurime shoq./sh	514.591	2.517.359
	Paga dhe shpërblime		2.008.114
	Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	514.591	509.245
9	Të Pagueshme për Detyrime Tatimore	67.232	60.754
	Shteti-Tatim mbi fitimin		
	Shteti-Tatim mbi vlerën e shtuar		
	Tatim mbi të ardhurat personale	51.910	45.432
	Tatimi në burim	15.322	15.322
10	Të tjera të Pagueshme	5.343.580	6.730.291
Shuma		24.285.139	68.415.154

“Të Pagueshme për Aktivitetin e Shfrytëzimit (furnitore)” pasqyron detyrimet ndaj furnitoreve për blerjen e mallrave e shërbimeve pa u likuiduar në fund të ushtrimit. Shoqëria ka përgatitur inventaret kontabel dhe shuma e llogarise sintetike është e barabartë me shumën e llogarive analitike të mbajtura për çdo furnitor. Drejtimi ka gjykuar se të drejtat e furnitoreve janë të vlerësuar realisht.

“Të Pagueshme ndaj Punonjësve dhe Sigurime shoqërore e shëndetësore” paraqet detyrimet e mbetura pa u paguar ndaj personelit dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore të muajit dhjetor 2019

“Të Pagueshme për Detyrime Tatimore” përbehet nga tatimi në burim dhe tatimi mbi të ardhurat personale të muajit dhjetor që do të paguhet në muajin janar 2020.

“Te tjera të pagueshme shumën prej 5.343.580 leke, përbehet nga shuma prej 3.581.969 leke përfaqësohet nga vlera e debitorëve të Kutallisë gjendje me 31.03.2018 transferuar me Vendimin e Keshillit Bashkiak nr.12 datë 31.03.2016, në pritje për tu kapitalizuar. Shuma prej 517.361 paguar e bordit dhe 64.260 leke paguar e papaguar e keshillit administrativ, 285.500 Kreditorë të tjerë ERU, dhe 848.590 leke kreditorë të tjerë BASEN, 45.900 detyrim pensioni për tu paguar.

Furnitorët e mbajtur në monedhë të huaj janë azhurnuar me kursin e datës së Bilancit Kontabël të publikuar nga Banka e Shqipërisë, në zbatim të kërkesave të SKK e përmirësuar nr.12 “Efekti i ndryshimeve të kurseve të këmbimit” paragrafet 13-18.

2.7 Detyrimet Afatgjata

“Të Pagueshme për Aktivitetin e Shfrytëzimit (furnitore)” pasqyron detyrimet ndaj furnitoreve për blerjen e mallrave e shërbimeve pa u likuiduar mbi një vit në shumën 59.106.750 leke.

Shuma e llogarise sintetike është e barabartë me shumën e llogarive analitike të mbajtura për çdo furnitor. Drejtimi ka gjykuar se të drejtat e furnitoreve janë të vlerësuar realisht.

2.8 KAPITALET E VETA

Kapitali i regjistruar i shoqërisë, i nënshkruar dhe i paguar dhe elementët e tjerë të seksionit të Kapitalit, paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar dhe Pasqyrën e Lëvizjeve të Kapitalit, është i njëjtë me atë të përcaktuar në statutin e shoqërisë dhe vendimet e depozituara në QKB.

- Kapitali i nënshkruar është vendosur teprica e llogarisë Kapitali themeltar në vlerën 170.366.002 lekë. E njëjtë me atë të citit të kaluar.
- Rezerva është vendosur teprica e llogarisë rezerva ligjore në vlerën 199.208 lekë.
- Rezerva te tjera ne shumen 4.379.217 leke.
- Humbja e mbartur është vendosur teprica e llogarisë në shumë - 57.192.503 lekë.
- Humbja e vitit financiar është vendosur teprica e llogarisë fitime dhe humbje të vitit ushtrimor në shumën – 27.582.574 lekë.
- Me shresen nr 2338 prot. Datë 27.08.2020 është bërë transferimi i Aktiveve afatgjata materiale nga Bashkia Ura Vajguore në shumën 119.510.924 lekë, e pozicionurr tek primi i kapitalit në pritje për ta kapitalizuar.

Pasqyra e performances**1. Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit dhe të tjera**

Te ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit dhe te tjera, ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2020, paraqiten:

1 Të Ardhura nga Aktiviteti i Shfrytëzimit:		
Shitje e produkteve te gatëshme dhe nënprodukteve	23.261.304	21.825.656
Shitja e punimeve dhe shërbimeve	-	-
Shitja e mallrave	-	-
Të ardhura nga shitje të tjera(qera,komisione,etj)		
Totali i të Ardhura nga Aktiviteti i Shfrytëzimit	23.261.304	21.825.656
2 Puna e Kryer nga Nj.E dhe e kapitalizuar	-	-
3 Të Ardhura të Tjera të Shfrytëzimit	9.543.494	8.339.000
Të ardhura nga grante te tjera (subvencion)	7.427.815	7.239.400
Hyrje ne inventar	882.742	
Të ardhura të tjera(Kamatvonesa, Libreza, kontrata dhe hyrje ne	1.211.965	1.099.600
Te ardhura nga gjobat	20.972	
Shuma	32.804.798	30.164.656

Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe shërbimeve jane vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara, te zhveshura nga TVSH-ja. (Njohja dhe vleresimi jane bazuar ne SKK 8 te permiresuar).

2. Shpenzimet e për lëndë të parë, materiale të konsumueshme dhe ndryshimi ne inventarin e Produkteve te Gatshme dhe Prodhimit ne Proces.

Shpenzimet e për lëndë të parë, materiale të konsumueshme dhe ndryshimi ne inventarin e produkteve te gatshme dhe prodhimit ne proces, ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2020, paraqiten:

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Viti raportues 31.12.2020	Viti raportues 31.12.2019
1	Ndryshime ne inventarin e P.te gatshme dhe P.Proces	-	-
2	Lënda e Parë dhe Materiale të Konsumueshme	24.827.440	22.934.141
	Lënda e Parë dhe Materiale	3.536.906	3.725.672
	Mallra (konsum inv imet	3.182	84.285
	Energji elektrike, uje	21.287.352	19.124.184
3	Te tjera shpenzime		
	Shuma	24.827.440	22.934.141

3. Shpenzime personeli

Shpenzimet e personelit përbehen nga pagat, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, leja vjetore e paguar, raporti mjekësor i paguar në 14 ditët e para, pjesëmarrja në fitime dhe shpërblimet. Numri mesatar i punonjesve dhe shpenzimet vjetore të kryera për personelin janë si me poshtë

Nr	Viti raportues	31.12.2020	Viti raportues	31.12.2019
1	Shpenzime Personeli			
	Paga dhe Shpërblime	21.061.990		21.803.256
	Shpenzime për Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore	3.541.389		3.657.998
	Të tjera	625.607		793.800
	Shuma	25.228.986		26.255.054
2	Numri mesatar vjetor i të punësuarve	50		50

4. Shpenzime të tjera shfrytëzimi

Në shpenzime të tjera të shfrytëzimit janë përfshirë kostot e shërbimeve kryesore dhe ndihmëse, që lidhen drejtpërdrejt me veprimtaritë e shfrytëzimit dhe ato për qëllime administrative, si dhe, kostot që ndodhin jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të biznesit.

Nr	Emertimi	Viti raportues 31.12.2020	Viti raportues 31.12.2019
I	Të Tjera Shpenzime		
1	Shërbime nga të tretët(llog.61-62)	1.720.154	2.476.082
	Trajtime të përgjithëshme(nga te trete)		
	Qera	108.000	423.712
	Mirmbajtje dhe riparime	87.000	829.130
	Sigurime	-	31.840
	Honorare	298.510	
	Sherbime nga te trete		675.827
	Shpenzime Basen + ERU	149.144	186.353
	Trasferime,udhëtime,dieta	157.000	199.000
	Shpenzime postare dhe telekomunikimi	63.700	2.770
	Shpen.fin	108.000	
	Shpenzime për shërbimet bankare		3.250
	Të tjera (QRA)	748.800	124.200
3	Tatime dhe taksa(llog.63)	271.604	
	Taksa dhe tarifa vendore	271.604	
	Taksa te regjistrimit		
	Tatime te tjera		
4	Shpenzime të tjera jo korente(llog.67)	-	301.789
	Vlera kontabël e AA te shitura	-	-
	Te tjera VI mbetur nga nxjerrjet jasht perdorimit te AAM-ve		301.789
5	Shpenzime të Tjera Shfrytëzimi(Gjoba,provizione) Llog.68	131.636	15.000
	Shpenzime per pritje dhe përfaqësime		
	Gjoba dëmshpërblime	131.636	15.000
	Provizione	-	-
	Te tjera		
	Shuma	2.123.394	2.476.082

5. Te ardhura te tjera. Shpenzimet financiare

Te ardhura te tjera dhe Shpenzimet financiare nuk ka

Nr	Viti raportues 31.12.2020	Viti paraardhës 31.12.2019
1 Te ardhura te tjera	-	-
Interesa te arketuara	-	-
Te ardhura te tjera financiare	-	-
Fitim nga kembimet dhe perkthimet valutore	-	-
2 Shpenzime financiare	-	-
Shpenzime per interesa	0	0
Shpenzime te tjera	-	-
Humbje nga kembimet dhe perkthimet valutore	-	-

Njohja e diferencave nga kurset e këmbimit, referuar paragrafit 15-16, të SKK 12 “Efekti i ndryshimeve të kurseve të këmbimit” I përmirëzuar, që krijohen gjatë shlyerjes së zërave monetarë ose gjatë përkthimit të zërave monetarë dhe jomonetarë me kurse këmbimi të ndryshme nga kurset e këmbimit, me të cilat ato janë përkthyer në njohjen gjatë periudhës kontabël aktuale ose në PF të mëparshme, njihen si fitim (ose humbje) të periudhës kontabël kur ato lindin. Kur transaksionet shlyhen në të njëjtën periudhë kontabël, në të cilën ai është kryer, e gjithë diferenca e këmbimit njihet në të njëjtën periudhë kontabël. Megjithatë, kur një transaksion shlyhet në një periudhë kontabël të mëparshme, diferenca e këmbimit e njohur në secilën periudhë deri në datën e shlyerjes, përcaktohet nga ndryshimi i kurseve të këmbimit gjatë secilës periudhë kontabël.

6. Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Ne vijim janë pasqyruar përbërësit më kryesorë të shpenzimeve (të ardhurave) tatimore të cilat përfshijnë: shpenzimet tatimore aktuale.

Nr.	Elementet e tatimit mbi fitimin	Viti raportues 2020		Viti raportues 2019	
		Shuma	Tatim fitimi	Shuma	Tatim fitimi
I	Shpenzimi Aktual i Tatimit mbi Fitimin				
1	Fitimi/(Humbja) Para Tatimit	(27.582.574)		(30.625.919)	
2	Të ardhura të njohura që përjashtohen nga tatimi mbi fitimin(-)				
	Dividentët e deklaruar dhe ndarjet e fitimit(nga investimet e k	-	-	-	-
	Të tjera(rimarrje provizionesh,gjobash etj)(-)	-	-	-	-
3	Shpenzime të panjohura tatimore(+)	-	-	-	-
	Shpenzime pritje e dhurime tej kufirit tatimor(+)		-		-
	Gjoka,penalitete,demshperblime(+)				
	Amortizim mbi normat fiskale(+)		-		-
	Provizione për rreziqe e shpenzime(+)		-		-
	Të tjera	-	-	-	-
	Diferenca pozitive- Shpenzimet tatimore të lejuara minus				
4	njohjet për qëllimet e raportimit(-)				
	Amortizimi i përshpejtuar tatimor(-)	-	-	-	-
	Të tjera(-)		-		-
5	Zbritja e humbjes tatimore(-)(viti 2014)				
6	Fitimi i Tatueshëm dhe shpenzime të tejm fitimit aktual	(27.582.574)	-	(30.625.919)	-
II	Shpenzim(të ardhura) i Tatim Fitimit të Shtyrë(+/-)	x	x		
III	Shpenzime(të ardhura) për Tatimin mbi Fitimin(I+II)	x	x		

Shoqëria për vitin 2020 rezulton me humbje.

Shpenzimi i tatim fitimit të periudhës ushtrimore 2020 është llogaritur mbi fitimin e tatueshëm pasi fitimit kontabël i janë shtuar shpenzimet e panjohura, referuar legjislacionit tatimor në fuqi në lidhje me Tatimin mbi të ardhurat. Ky detyrim pakësohet me shumën e parapagimit më tepër të

7. Ngjarjet pas datës së bilancit dhe vazhdimësia e shfrytëzimit

Asnjë ngjarje e rëndësishme nuk ka ndodhur pas datës së miratimit të pasqyrave financiare.

8. Shpjegime mbi palët e lidhura


Me marrjen në konsiderate të çdo transaksioni dhe marredhënie të mundshme, jo thjesht formën ligjore të tyre në 31 dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019 nuk ka transaksione me palët e lidhura.

9. Shifrat krahasuese

Pasqyrat financiare të vitit 2020 janë hartuar dhe paraqitur në përputhje me formatet që janë dhënë në shtojcën e standardit SKK-2,(të përmirësuar) dhe çeljet e vitit 2020

Pasqyrat financiare janë aprovuar nga drejtimi i “Ujësjetllës Kanalizime Sha Ura Vajgurore” sh.a dhe jane firmosur nga:

ADMINISTRATORI
Petref SULA



HARTUESI
Nigjare PAJO

